AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Arsimit të Lartë sipas fushave të studimit, 2022/2023

17.10.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Arsimit të Lartë sipas fushave të studimit për vitin akademik 2022/2023.

Numri më i madh i studentëve të regjistruar për herë të parë shënohet në fushën "Biznes, Administratë dhe Ligj"

Numër më i madh i studentëve të regjistruar për herë të parë në arsimin e lartë në nivelin Bachelor është shënuar në fushat "Biznes, administratë dhe ligj" me gjithsej 4 268 studentë ose 25,0% e numrit të përgjithshëm të studentëve. Ndërsa, numër më i vogël i studentëve janë regjistruar në fushat "Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinari" me gjithsej 365 studentë ose 2,1%.

Po ashtu, vërehet numër i vogël i studentëve të cilët kanë zgjedhur të studiojnë në fushën e "Arsimit" me gjithsej 390 ose 2,3%.

Studentët e regjistruar për herë të parë në nivelin Bachelor sipas fushave të studimit në universitete publike dhe kolegje private

Fusha e studimit	Femra	Meshkuj	Gjithsej
Arsimi	366	24	390
Arte dhe shkenca humane	1 469	616	2 085
Shkencat shoqërore, gazetari dhe informim	1 450	335	1 785
Biznes, administrata dhe ligji	2 283	1 985	4 268
Shkencat natyrore, matematikë dhe statistikat	345	164	509
Teknologjia Informative dhe Komunikimi (TIK)	871	1 830	2 701
Inxhinieri, prodhimi dhe ndërtimi	903	1 068	1 971
Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinari	230	135	365
Shëndeti dhe mirëqenia	1 844	618	2 462
Shërbime	178	338	516
Gjithsej	9 939	7 113	17 052

Numër më i madh i femrave në fushën "Teknologjia Informative dhe Komunikimi (TIK)"

Në fushën e studimit "Teknologjia Informative dhe Komunikimi" (TIK) në nivelin Bachelor, krahasuar me vitin paraprak kemi një numër më të madh të femrave, ku për vitin 2021/2022 numri i femrave në këtë fushë ishte 2 195 ose 28,8%, ndërsa në vitin akademik 2022/2023 ishte 2 348 ose 32,4%.

Interesim më i madh i studentëve në nivelin Master në fushën "Biznes, administratë dhe ligj" në universitete publike dhe kolegje private

Nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për herë të parë në nivelin Master, 1 528 studentë, janë regjistruar në fushën "Biznes, administratë dhe ligj" ose shprehur në përqindje 37,1%

e numrit të përgjithshëm. Ndërsa, vërehet numër i vogël i studentëve të regjistruar në fushën "Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë", me gjithsej 65 studentë ose 1,6% e numrit të përgjithshëm.

Diferencë më e madhe ndërmjet femrave dhe meshkujve te fusha e Arsimit

Krahasuar me numrin e përgjithshëm të studentëve, që ndjekin arsimin e lartë në nivelin Master, dominon numri i studentëve të cilët ndjekin studimet në fushat "Biznes, administratë dhe ligj" me gjithsej 3 853, ose 36,0% e numrit të përgjithshëm. Diferencë më e madhe gjinore vërehet edhe tek niveli Master në fushën e "Arsimit " ku nga 1 075 studentë, 83,0% janë femra, ndërsa 178 janë meshkuj ose 16,6%.

Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin Bachelor për vitin akademik 2021/2022 dhe 2022/2023

Arsimi		Arte dhe Shkenca humane		Shkencat shoqërore, gazetari dhe informim		Biznes, administrata dhe ligji		Shkencat natyrore, matematikë dhe statistikat	
2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23
4 352	2 349	8 408	7 277	3 696	5 913	21 179	16 877	1 860	2 288
Teknologjia Informative dhe Komunikimi (TIK)		Inxhinieri, prodhimi dhe ndërtimi		Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinari		Shëndeti dhe mirëqenia		Shërbime	
2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23
7 634	7 243	7 309	6 224	1 595	1 327	11 396	9 555	2 755	2 033

Numri i përgjithshëm i studentëve në nivelin Master për vitin akademik 2021/2022 dhe 2022/2023

Arsimi		Arte dhe Shkenca humane		Shkencat shoqërore, gazetari dhe informim		Biznes, administrata dhe ligji		Shkencat natyrore, matematikë dhe statistikat	
2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23
1026	1075	1085	1016	779	648	5149	3853	368	310
Teknologjia Informative dhe Komunikimi (TIK)		Inxhinieri, prodhimi dhe ndërtimi		Bujqësi, pylltari, peshkim dhe veterinari		Shëndeti dhe mirëqenia		Shërbime	
2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23	2021/22	2022/23
469	549	1532	1273	313	325	866	1172	290	474

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Statistikave të Arsimit sipas fushave të studimit 2022/2023, vizitoni: **https://ask.rks-gov.net/Themes/Education**